



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE  
УСТАВНИ СУД  
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 27 qershor 2022  
Nr.ref.:RK 2017/22

## **AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI**

në

**rastin nr. KI234/21**

Parashtrues

N.P.N “Çlirimi”

**Vlerësim i kushtetutshmërisë  
së Njoftimit [KMLC.nr.88/2021] të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, të 20  
gushtit 2021; dhe Aktvendimit [Ac.nr.4662/20], të Gjykatës së Apelit në  
Prishtinë, të 25 majit 2021**

### **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare  
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar  
Selvete Gërxxhaliu-Krasniqi, gjyqtare  
Safet Hoxha, gjyqtar  
Radomir Laban, gjyqtar  
Remzie Istrefi-Peci, gjyqtare dhe  
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Kërkesa është dorëzuar nga N.P.N. “Çlirimi” me pronar Sali Dakaj nga fshati Korishë komuna e Prizrenit, të cilën e përfaqëson avokati Bajram Morina nga Gjakova (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Njoftimin [KMLC.nr.88/2021] të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, të 20 gushtit 2021; dhe Aktvendimin [Ac.nr.4662/20], të Gjykatës së Apelit në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit), të 25 majit 2021.

## **Objekti i çështjes**

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Njoftimit [KMLC.nr.88/2021] të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, aktvendimit të lartcekur, me të cilat pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 7 [Vlerat], 21 [Parimet e Përgjithshme], 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] dhe 54 [Mbrotjtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

## **Baza juridike**

4. Kërkesa bazohet në paragrafin 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] dhe paragrafin 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

5. Më 29 dhjetor 2021, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) pranoi kërkesën e parashtruesit të kërkesës, të cilën ai e kishte dorëzuar në postë më 25 dhjetor 2021.
6. Më 10 janar 2022, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Remzie Istrefi Peci, Gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Selvete Gërxhaliu Krasniqi (kryesuese), Safet Hoxha dhe Radomir Laban, anëtarë.
7. Më 11 janar 2022, Gjykata e njoftoi përfaqësuesin e parashtruesit të kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe nga një kopje të kërkesës ua dërgoi Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit dhe Gjykatës së Apelit.
8. Më 8 qershor 2022, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarës raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

## **Përmbledhja e fakteve**

9. Bazuar në shkresat e lëndës, parashtruesi i kërkesës ka një kontest me kompaninë Excom Sh.p.k me seli në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: Excom), ku pretendon që Excom nuk ia ka paguar borxhin në shumë prej 3,992,708.44 ( tre milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e dy mijë e shtatëqind e tetë euro e dyzet e katër cent) euro.
10. Në një datë të pasaktësuar, parashtruesi i kërkesës kishte bërë propozim për përmbarim tek Përmbaruesi Privat Fadil Hoxha, përmbarues për territorin e Gjykatës Themelore në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: Përmbaruesi privat), ku kishte kërkuar që të aprovohet propozimi për përmbarim ndaj debitorit Excom, për realizimin e kërkesës në

të holla në shumën prej 3,992,708.44 ( tre milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e dy mijë e shtatëqind e tetë euro e dyzet e katër cent) euro.

11. Më 6 qershor 2018, Përmbauesi privat përmes urdhërit përmbaorimor [P.nr.695/2018], aprovoi propozimin për përmbaorim të parashtruesit të kërkesës, ku caktoi përmbaorimin dhe obligoi debitorin Excom që parashtruesit të kërkesës t'ia paguaj shumën prej 3,992,708.44 ( tre milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e dy mijë e shtatëqind e tetë euro e dyzet e katër cent) euro, me kamate ligjore nga dita e lejimit të përmbaorimit e gjerë ne pagesën definitive, në emër të mos pagesës te borxhit që rrjedhë nga faturat e përmendura në propozimin për përmbaorim te kreditorit, si dhe shpenzimet e procedurës përmbaorimore.
12. Më 12 qershor 2018, debitorin Excom paraqiti prapësim pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore) kundër urdhërit përmbaorimor [P.nr.695/2018] të 6 qershorit 2018 të Përmbauesit privat.
13. Më 24 korrik 2020, Gjykata Themelore përmes Aktvendimit [PPP. nr.737/18] aprovoi si të bazuar në tërësi prapësimin e debitorit Excom dhe shfuqizoi urdhërin përmbaorimor [P.nr.695/2018] të 6 qershorit 2018 të Përmbauesit privat.
14. Më 29 gusht 2020, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore, ku kërkoi që të prishet dhe ndryshohet Aktvendimi [PPP.nr.737/18] i Gjykatës Themelore, ashtu që të refuzohet në tërësi prapësimi i debitorit Excom, ndërsa urdhëri përmbaorimor i Përmbauesit privat të vërtetohet në tërësi si i bazuar.
15. Më 25 maj 2021, Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [ Ac.nr.4662/20] refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi Aktvendimin [PPP.nr.737/18] të 24 korrikut 2020 të Gjykatës Themelore.
16. Më 26 korrik 2021, parashtruesi i kërkesës paraqiti propozim për iniciimin e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë, pranë Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit.
17. Më 20 gusht 2021, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit përmes njoftimit [KMLC.nr.88/2021] nuk e aprovoi propozimin për iniciimin e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë, të parashtruar nga parashtruesi i kërkesës.

#### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

18. Parashtruesi i kërkesës pretendon para Gjykatës se Aktvendimi i Gjykatës Themelore [PPP.nr.737/18], Aktvendimi i Gjykatës së Apelit [Ac.nr.4662/20] dhe Njoftimi [KMLC.nr.88/2021] i Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, janë nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tij të garantuara me nenin 7 [Vlerat], 21 [Parimet e Përgjithshme], 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës.
19. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata e Apelit "nuk ka vendosur ne mënyrë meritore dhe nuk ka dhënë përgjigjeje konkrete (te qarte) lidhur me pretendimet e Kreditorit te parashtruar ne Ankesën e tij te datës 29.08.2020, edhe pse ka gene e detyruar ta beje sipas detyrës zyrtare, me çka ka vepruar ne kundërshtim me dispozitat e nenit 194 te Ligjit mbi Procedurën Kontestimore, të aplikueshme sipas bazës së nenit 17 te LPP, pasi po të kishte vendosur në mënyrë meritore dhe në baze të ligjit në fuqi, lidhur me pretendimet ankimore të kreditorit, do të kishte vërtetuar se : prapësimi i debitorit, i datës 13.06.2018 është i pabazuar, dhe se Gjykata e shkalles së

*parë ka shfuqizuar në kundërshtim me ligjin ne fuqi Urdhërin Përmbarimor te Përmbaruesit Privat”.*

20. Tutje parashtruesi i kërkesës thekson se aktvendimit të Gjykatës së Apelit i mungojnë arsytet ligjore për refuzimin e ankesës së tij për shkak se siç thekson ai “Gjykata e shkallës së dytë, e ka vërtetuar Aktvendimin e Gjykatës së shkallës së parë, edhe pse Gjykata e shkallës së parë ka aplikuar gabimisht dhe ne dëme të kreditorit të drejtën materiale, dhe këtë duke konstatuar gabimisht se gjëja lidhur me objektin e procedurës përmbarimore janë duke u zhvilluar dy lëndë gjyqësore gjëja për të njëjtën çështje juridike sikurse në procedurën përmbarimore, pasi me leximin e faktuarve të kreditorit që i janë bashkangjitur Propozimit të përmbarim, dhe te padisë së debitorit të regjistruar ne Gjykatën Themelore ne Prishtinë-Departamenti për çështje Ekonomike me nr. IV. EK. Nr. 426/18, vërtetohet se objekti i padisë të debitorit është kompensimi i dëmit - penaleve për vonese në ekzekutimin e punëve, rrethane kjo që vërtetohet me leximin e padisë të debitorit”.
21. Parashtruesi i kërkesës pretendon se si gjykata e shkallës së parë, ashtu edhe gjykata e shkallës së dytë, ka bërë seleksionim negativ të fakteve - provave në raporte dhe në dëme të tij, pasi në rastin konkret në procedurën e gjertanishme, që të dy gjykatat e kanë favorizuar debitorin tani për tani për motive të panjohura për kreditorin, dhe kanë anashkaluar provat materiale dhe pretendimet e kreditorit të precizuara në parashtrimet e tija të deponuara në të dy gjykatat, të arsyetuar me argumente të shumta ligjore dhe faktike. Më tej ai thekson se “ në bazë të dispozitave të nenit 37 te LPP, është përcaktuar se : “ Kur propozimi për përmbarim paraqitet ne baze te dokumentit te besueshëm (siç ka ndodhur ne rastin konkret), mjafton që propozimit për përmbarim ti bashkëngjitet dokumenti ne origjinal apo kopja e vërtetuar e tij sipas ligjit , kurse me dispozitat e nenit 29, parag. 3 te LPP, është përcaktuar se : “ Dokumenti i besueshëm, është i përshtatshëm për përmbarim, nëse në të është treguar : kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shumat dhe koha e përmbushjes të detyrimit monetar”, kushte këto që janë plotësuar nga kreditori, bazuar ne faktin jokontestues se kreditori Propozimit te tij për përmbarim ia ka bashkangjitur kopjet e vërtetuara nga Noteri te faktuarve të lartpërmendura, ne te cilat janë precizuar të dhënat e kërkuara konform dispozitave te lartpërmendura, dhe si te tilla janë të përshtatshme për përmbarim, por ky fakt po ashtu është anashkaluar nga Gjykata e shkallës së parë për motive te panjohura për kreditorin, mirëpo për qudi ky fakt nuk e ka penguar Gjykatën e Apelit që të refuzoj Ankesën e kreditorit dhe që të vërtetoj aktvendimin e Gjykatës së shkallës së parë”.
22. Sipas parashtruesit të kërkesës urdhëri përmbarimor i Përmbaruesit Privat [P.695/18] i 6 qershorit 2018, me të cilin ishte urdhëruar debitori Excom që parashtruesit të kërkesës t’ia paguaj shumën e precizuar në urdhërin përmbarimor, i cili ishte shfuqizuar nga Gjykata Themelore, sipas parashtruesit në mënyrë të pa rregullt sepse urdhëri ishte i rregullt dhe si të tillë Gjykata Themelore është dashur ta vërtetojë dhe jo ta shfuqizojë. Tutje ai thekson se në prapësimin e debitorit nuk ekziston asnjë prej shkaqeve nga neni 71 i Ligjit të Procedurës Përmbarimore për aprovimin e prapësimit, me çka sipas tij vërtetohet se Gjykata e Apelit ka vërtetuar pa asnjë bazë ligjore aktvendimin e Gjykatës Themelore. Ai thekson se “gjykata e shkallës së dytë, ka vërtetuar aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë, edhe pse kjo gjykate ka vendosur sikurse të ishte duke vendosur ne procedure kontestimore, dhe këtë ne kundërshtim me dispozitat ligjore te LPP-së, rrethanë kjo që vërtetohet edhe me leximin e pjesës të arsytimeve të aktvendimeve me të cilat është vendosur ne Gjykatën e Apelit për ankesat në procedurën përmbarimore”. Lidhur me këtë ai i referohet disa prej vendimeve të Gjykatës së Apelit, duke parafrazuar pjesë nga ato vendime.



23. Më tej parashtruesi thekson se pretendimet e debitorit se ai ia ka borxh një shumë të caktuar parash , e të cilat Gjykata Themelore i ka konsideruar si të besueshme, janë të pa bazuara në tërësi pasi që sipas tij mbështeten në ekspertiza kontestuese të ekspertit financiar dhe të ndërtimtarisë, të cilët nuk janë nxjerrë si prova në procedure përmbarimore, por ka qene objekt i administrimit ne procedurën kontestimore.
24. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata e Apelit e ka vërtetuar aktvendimin e Gjykatës Themelore edhe pse ajo Gjykatë kishte nxjerr aktvendim të njëanshëm dhe pa bazë ligjore : (i) kishte aprovuar prapësimin e debitorit edhe pse nuk përmban asnjë nga shkaqet e përmendura me nenin 71 të LPP-së; (ii) aktvendimin e saj e ka arsyetuar me një arsyetim të përgjithshëm – nuk ka vlerësuar drejtë provat dhe faktet; (iii) ka konstatuar se gjëja kredia është shuar konform dispozitave të nenit 71 paragrafi 1.8 i LPP-së; (iv) ja ka falë besimin deklaratës së të autorizuarit të debitorit të dhënë në seancën e fundit dëgjimore, në të cilën ka theksuar se gjoja kreditorit ia ka paguar borxhin; (v) është ndikuar nga deklarata pa mbulesë dhe e pa mbështetur në prova materiale të autorizuarit për gjoja pagesën e faktuarve.
25. Sipas parashtruesit të kërkesës *“Gjykata e shkallës së dytë, ka vërtetuar aktvendimin e gjykatës se shkallës së parë, edhe pse kjo gjykatë ka vendosur sikurse të ishte duke vendosur në procedurë kontestimore, dhe këtë në kundërshtim me dispozitat ligjore të LPP-së, rrethanë kjo që vërtetohet edhe me leximin e pjesës te arsyetimeve te aktvendimeve me të cilat është vendosur ne Gjykatën e Apelit për ankesat ne procedurën përmbarimore”*. Lidhur me këtë parashtruesi i kërkesës iu referohet disa vendimeve të Gjykatës së Apelit siç janë Aktvendimet e Gjykatës së Apelit: Ac.Nr. 88/17, i datës 27.07.2017; Ac. Nr. 2060/2015, i datës 12.11.2015; Ac. Nr. 6091/19, i datës 29.06.2020; Ac. Nr. 3007/19, i datës 21.01.2020; Ac. Nr. 2631/2019, i datës 16.01.2020; Ac. Nr. 3988/2016, i datës 07.09.2017.
26. Tutje parashtruesi i kërkesës thekson se ishte dëmtuar rëndë me aktvendimet e Gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë, dhe se për këtë arsye i ishte drejtuar Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit me propozimin për parashtrimin e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë, mirëpo sipas tij Prokurori i Shtetit përmes Njoftimit KMLC, Nr. 88/2021, të 20 gushtit 2021 e ka njoftuar parashtruesin e kërkesës se nuk ekzistojnë arsyet e mjaftueshme ligjore për ngritjen e Kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë te parapara me nenin 247, parag. 247.1, pika a) dhe pika b) te Ligjit për Procedurën Kontestimore, kështu që sipas parashtruesit *“për këtë arsye kam vendosur që të parashtroje këtë kërkesë ne Gjykatën Kushtetuese, për shkak shkeljes së ligjit në fuqi në dëm të kreditorit dhe shkeljes se të drejtave të njeriut të garantuara me Kushtetutën e Kosovës”*.
27. Në fund parashtruesi i kërkesës nga Gjykata kërkon që: (i) anulohet Njoftimi [KMLC.nr.88/2021] i 20 gushtit 2021 i Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, Aktvendimi [Ac.nr.4462/20] i 25 maj 2021 i Gjykatës së Apelit dhe Aktvendimi [PPP.nr.737/18] i 24 korrikut 2020 i Gjykatës Themelore, dhe çështja të kthehet në rigjykim dhe rivendosje; (ii) lënda ti kthehet Gjykatës së Apelit për të vendosur sërish lidhur me ankesën e 28 gushtit 2020 të parashtruar kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore [PPP.nr.737/18] të 24 korrikut 2020.

## **Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore**

### **Kushtetuta e Republikës së Kosovës**

#### **Neni 7 [Vlerat]**

1. *Rendi kushtetues i Republikës së Kosovës bazohet në parimet e lirisë, paqes, demokracisë, barazisë, respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe sundimit të ligjit, mosdiskriminimit, të drejtës së pronës, mbrojtjes e mjedisit, drejtësisë sociale, pluralizmit, ndarjes së pushtetit shtetëror dhe ekonomisë së tregut.*
2. *Republika e Kosovës siguron barazinë gjinore si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë, mundësi të barabarta për pjesëmarrje të femrave dhe meshkujve në jetën politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe në fushat të tjera të jetës shoqërore.*

#### **Neni 21 [Parimet e Përgjithshme]**

1. *Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të pacenueshme dhe janë bazë e rendit juridik të Republikës së Kosovës.*
2. *Republika e Kosovës mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të parashikuara në këtë Kushtetutë.*
3. *Çdokush e ka për detyrë t'i respektojë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të të tjerëve.*
4. *Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme.*

#### **Neni 24 [Barazia para Ligjit]**

1. *Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.*
2. *Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.*
3. *Parimet e mbrojtjes së barabartë ligjore nuk parandalojnë vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë. Masat e tilla do të zbatohen vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin janë vënë ato.*

#### **Neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]**

- "1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.*
- 2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj."*
- [...]*

#### **Neni 53**

## **[Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut]**

*Të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.*

### **Neni 54**

#### **[Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave]**

*Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur.*

## **LIGJI NR. 04/L-139 PËR PROCEDURËN PËRMBARIMORE**

### **Neni 68**

#### **Mjetet e jashtëzakonshme juridike**

- 1. Nuk është i lejuar revizioni dhe përsëritja e procedurës në procedurën përmbarimore.*
- 2. Kthimi në gjendjen e mëparshme është i lejuar vetëm në rastet e mos ruajtjes së afateve për paraqitjen e prapësimit dhe ankesës kundër vendimeve të përmbarueshëm për përmbarimin me dhunë.*

#### **Vlerësimi i Pranueshmërisë së kërkesës**

28. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe të përcaktuara me Rregullore të punës.
29. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

*“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*

*[...]*

*7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”*

30. Gjykata gjithashtu i referohet paragrafit 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës, i cili përcakton:

*“4. Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejné edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme.”*

31. Gjykata fillimisht vëren se në pajtim me paragrafin 4 të nenit 21 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës ka të drejtë të paraqesë ankesë kushtetuese, duke iu referuar shkeljeve të pretenduara të të drejtave dhe lirive themelore të tij, të vlefshme për individët dhe personat juridik (shih rastin e Gjykatës Kushtetuese nr. KI41/09, parashtruesi i kërkesës *Universiteti AAB-RIINVEST L.L.C.*, Aktvendimi për papranueshmëri i 3 shkurtit 2010, paragrafi 14; dhe KI35/18, me parashtrues *“Bayerische Versicherungsverband”*, Aktgjykim i 11 dhjetorit 2019, paragrafi 40).

32. Gjykata gjithashtu konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar i cili konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Njoftimin [KMLC.nr.88/2021] të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, të 20 gushtit 2021; dhe Aktvendimin [Ac.nr.4462/20], të Gjykatës së Apelit, të 25 majit 2021.
33. Gjykata në vazhdim i referohet nenit 47 [Kërkesa individuale] dhe 48 [Saktësimi i kërkesës] të Ligjit, që përcaktojnë:

Neni 47  
[Kërkesa individuale]

*“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.*

*2. Individit mund të ngre kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”*

Neni 48  
[Saktësimi i kërkesës]

*Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.*

34. Gjykata shqyrton gjithashtu nëse janë përmbushur kriteret e përcaktuara me nenin 49 [Afatet] të Ligjit dhe rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë], respektivisht paragrafët (1) (b) dhe (c) të Rregullores së punës. Ato përcaktojnë si në vijim:

Neni 49 i Ligjit  
[Afatet]

*“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”*

Rregulli 39 i Rregullores së punës  
[Kriteret e pranueshmërisë]

*“(1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:*

*[...]*

*b) janë shteruar të gjitha mjetet efektive të përcaktuara me ligj kundër aktgjykimit ose vendimit të kontestuar;*

*c) kërkesa parashtrohet brenda katër (4) muajsh nga dita kur vendimi i mjetit të fundit efektiv juridik i është dorëzuar parashtruesit, dhe*

*[...].”*

35. Në këtë kontekst, Gjykata rikujton se si rregull, afati 4 (katër) mujor fillon nga “vendimi i fundit” në procesin e shterjes së mjeteve juridike me të cilin është refuzuar kërkesa e parashtruesit të kërkesës (shih *mutatis mutandis*, rastet e GJEDNJ-së, *Gavrilov kundër Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë*, aplikimi nr.7837/10, Vendim i 1 korrikut 2014, paragrafi 25; dhe *Paul dhe Audrey Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, aplikimi nr.46477/99, Vendim i 14 marsit 2002).



36. Gjykata rikujton po ashtu se parashtruesi i kërkesës duhet t'i shterojë të gjitha mjetet juridike të cilat pritet të jenë efektive dhe të mjaftueshme. Vetëm mjetet efektive mund të merren parasysh nga Gjykata, pasi parashtruesi i kërkesës nuk mund të zgjasë afatet kohore strikte të parapara me Ligj dhe Rregullore të punës, duke u përpjekur të ushtrojë mjete juridike të cilat nuk janë efektive që të ofrojnë mbrojtje të të drejtave për të cilat ankohet parashtruesi i kërkesës (shih, *mutatis mutandis*, rastet e GJEDNJ-së, *Gavrilo kundër Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë*, cituar më lart, paragrafi 25; dhe, *Fernie kundër Mbretërisë së Bashkuar*, aplikimi nr.14881/04, Vendim i 5 janarit 2006). Lidhur me kriteret e lartcekura, Gjykata vlerëson fillimisht se kërkesa për shterjen e mjeteve juridike dhe kriterin që kërkesa të paraqitet brenda afatit prej 4 (katër) muajve janë të ndërlidhura ngushtësisht (shih, *mutatis mutandis*, rastin e GJEDNJ-së *Jeronovičs kundër Latvisë*, aplikimi nr.44898/10, *Aktgjykim i 5 korrikut 2016, paragrafi 75*).
37. Në këtë aspekt, Gjykata në vazhdim do të vlerësojë nëse në rrethanat e rastit konkret Njoftimi [KMLC.nr.88/2021] i Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, i 20 gushtit 2021 ishte mjet efektiv lidhur me pretendimet e parashtruesit për shkelje kushtetuese. Përgjigja në këtë pyetje, do të jetë vendimtare për vlerësimin nëse kërkesa e parashtruesit të kërkesës është paraqitur brenda afatit katër (4) mujor.
38. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se në rastin konkret, procedura ndaj parashtruesit të kërkesës e zhvilluar para gjykatave të rregullta në lidhje me ligjshmërinë e Urdhrit përmbartimor [P.nr.695/2018] dhe çështjen e përmbartimit të faturave kontestuese ishte zhvilluar para dy instancave gjyqësore, Gjykatës Themelore dhe asaj të Apelit, që kishte rezultuar me nxjerrjen e Aktvendimit të Gjykatës së Apelit [Ac.nr.4662/20] të 25 majit 2021.
39. Sipas nenit 68 (Mjetet e jashtëzakonshme juridike) të Ligjit për Procedurën Përmbartimore parashihet se "*nuk lejohen revizioni dhe përsëritja e procedurës ne procedurën përmbartimore*". Andaj, parashtruesi i kërkesës nuk kishte mjet juridik në dispozicion, që mund të përdorte "*personalisht*" për të sfiduar Aktvendimin e lartcekur të Gjykatës së Apelit, para Gjykatës Supreme.
40. Megjithatë, pas pranimit të Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, parashtruesi i kërkesës i ishte drejtuar Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, me propozimin që kjo e fundit të paraqesë në emër të parashtruesit të kërkesës, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë para Gjykatës Supreme, kundër Aktvendimit të Gjykatës së Apelit. Lidhur me këtë, Gjykata thekson se kjo kërkesë është plotësisht diskrecionale për Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit.
41. Në këtë aspekt, duke u bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ, në harmoni me të cilën, bazuar në nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë, KEDNJ nuk kërkon që mjetet juridike diskrecionale, apo mjetet juridike që nuk janë drejtpërdrejtë në dispozicion të parashtruesve dhe që varen nga ushtrimi i diskrecionit nga ndërmjetësi, siç është rasti me kërkesën para Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit juridike, duhet të shteren para se parashtruesit e kërkesave t'i drejtohen GJEDNJ-së (shih, *mutatis mutandis*, rastin e GJEDNJ-së *X dhe të tjerët kundër Letonisë*, Vendim i 6 qershorit 2008, paragrafi 20, dhe referencat e cekura aty; shih po ashtu rastin e Gjykatës KI174/20, me parashtrues *DE-KO SH.p.k*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 25 shkurtit 2021, paragrafi 38).
42. Më konkretisht, lidhur me propozimet e ngjashme, siç është propozimi që bëhen para Zyrës së Prokurorit të Shtetit, duke kërkuar që ky i fundit të paraqesë kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë para organeve gjyqësore në emër të parashtruesve të kërkesave,

GJEDNJ kishte trajtuar në rastin *Lepojić kundër Serbisë*. Në këtë rast, GJEDNJ kishte vlerësuar nëse propozimi i paraqitur para prokurorit të shtetit duke kërkuar që ky i fundit të paraqesë kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë është mjet efektiv, ku kishte deklaruar se “[GJEDNJ] gjen se është vetëm prokurori i shtetit ai që mund të dorëzoj [kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë] në emër të parashtruesit, dhe, për më tepër, ky i fundit ka diskrecion nëse dëshiron të bëjë një gjë të tillë. Përderisa parashtruesi i kërkesës mund të kërkojë një veprim të tillë të prokurorit, ai nuk ka të drejtë sipas ligjit për të përdorur një mjet të tillë juridik [kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë] personalisht [...] Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, për këtë arsye, ishte jo efektive [...]” (shih rastin e GJEDNJ-së *Lepojić kundër Serbisë*, aplikimi nr. 13909/05, Aktgjykim i 6 nëntorit 2007, paragrafi 54; po ashtu shih rastin e Gjykatës KI174/20, cituar më lartë, paragrafi 39).

43. Po ashtu, duke u thirrur në këtë praktikë gjyqësore (rastin e GJEDNJ-së *Lepojić kundër Serbisë*), GJEDNJ në rastin *Stojanovski kundër ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë*, nuk kishte marrë për bazë njoftimin e prokurorit të shtetit për qëllim të llogaritjes së afatit, kur ky i fundit kishte konstatuar se nuk kishte bazë të mjaftueshme për të paraqitur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë para Gjykatës Supreme të Maqedonisë. GJEDNJ në këtë rast kishte theksuar se “kërkesa e parashtruesit para prokurorit publik, nuk ishte mjet që duhej të shterej për qëllime [KEDNJ]. Rrjedhimisht, periudha kohore për të përdorur atë mjet juridik nuk e ndal rrjedhjen e afatit gjastë (6) mujor [për të paraqitur kërkesë para GJEDNJ lidhur me vendimin e Gjykatës së Apelit]” dhe rrjedhimisht, GJEDNJ gjeti se kërkesa e parashtruesit të kërkesës ishte paraqitur jashtë afatit të paraparë (shih, rastin e GJEDNJ-së *Stojanovski kundër ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë*, aplikimi nr. 1431/03, Vendim i 16 shtatorit 2008). Në rrethana të ngjashme GJEDNJ kishte mbajtur të njëjtin qëndrim edhe në rastin *Knapic kundër Kroacisë* (Shih rastin e GJEDNJ *Knapic kundër Kroacisë*, aplikimi nr. 2839/08, Vendim i 4 qershorit 2009).
44. Megjithatë, Gjykata rikujton që praktika e saj gjyqësore, njeh edhe raste në të cilat është vlerësuar kushtetutshmëria e njoftimeve të Prokurorit të Shtetit përmes së cilit nuk është pranuar kërkesa e palëve për ngritje të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë në favor të tyre. Lidhur me këtë, Gjykata i referohet rastit të saj nr. KI42/18, parashtruese *Asija Muslija*, Aktvendim për papranueshmëri, i 22 marsit 2020, i cili kishte vlerësuar pretendimet e parashtrueses për shkelje kushtetuese ndaj Njoftimit të Prokurorit të Shtetit, mbështetur edhe në rastin e GJEDNJ *Gorou kundër Greqisë* (Nr. 2), aplikimi nr.12686/03, Aktgjykim i 20 marsit 2009.
45. Megjithatë, rasti i lartcekur, KI42/18, dallon nga rasti konkret. Në këtë kontest, Gjykata rikujton se në rastin e lartcekur, KI42/18, parashtruesja e kërkesës kishte kontestuar specifikisht Njoftimin KMLC nr. 09/2018 të Prokurorit të Shtetit, të 2 marsit 2018, duke argumentuar se si ky Njoftim kishte shkelur të drejtat e saj kushtetuese, që ndërlihdeshin, mes tjerash, edhe me mungesën e arsytimit të pretenduar të Njoftimit të kontestuar të Prokurorit të Shtetit. Ndërsa lidhur me Aktvendimit AC. nr. 3538/2017 të Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës, të 8 dhjetorit 2017, që po ashtu ishte kontestuar në rastin KI42/18, si pretendim kryesor ishte mosvërtetimi i faktit nga Gjykata e Apelit se parashtruesja e kërkesës nuk e kishte nënshkruar Kontratën për Hipotekën të 2 dhjetorit 2011. Kërkesa e parashtruesit të kërkesës së rastit KI42/18, lidhur me Aktvendimin AC. nr. 3538/2017 të Gjykatës së Apelit ndaras nga Njoftimi i Zyrës së Kryeprokurorit, ishte paraqitur në Gjykatë po ashtu brenda afatit të paraparë me Ligj dhe Rregullore të punës.
46. Ndërsa, në rastin konkret, parashtruesi i kërkesës nuk paraqet pretendime specifike që kanë të bëjnë me arsyet e dhëna nga Njoftimi i Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit dhe se si Njoftimi i kësaj të fundit për të mos paraqitur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë

para Gjykatës Supreme kishte cenuar të drejtat kushtetuese të parashtruesit të kërkesës. Pretendimet e parashtruesit në kërkesën e tanishme ndërlidhen me pretendimet se *“prapësimi i debitorit, i datës 13.06.2018 është i pabazuar, dhe se Gjykata e shkallës së parë ka shfuqizuar në kundërshtim me ligjin në fuqi Urdhërin përmbarimor të Përmbaruesit Privat”*.

47. Gjykata vëren se këto pretendime ishin shqyrtuar nga Gjykata e Apelit dhe jo nga Zyra e Prokurorit të Shtetit. Kjo e fundit, në fakt, kishte vendosur vetëm nëse janë plotësuar kushtet ligjore që të paraqitet një kërkesë e tillë në Gjykatën Supreme.
48. Në këtë aspekt, Gjykata rikujton se në Njoftimin [KMLC.nr.88/2021] i 20 gushtit 2021, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit informoi parashtruesin e kërkesës se ishte refuzuar propozimi i tij për iniciimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore [PPP.nr.783/2019] të 24 korrikut 2020 dhe Aktvendimit të Gjykatës së Apelit [Ac.nr.4662/2020] të 25 majit 2021, pasi konsideroi se nuk ishin plotësuar kushtet ligjore për ngritjen e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë të parapara me Ligjin e Procedurës Kontestimore përkatësisht sipas dispozitës së nenit 247.1 pika a) dhe pika b).
49. Andaj, bazuar në praktikën e GJEDNJ-së, Gjykata rikujton se, në rastin konkret, kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë përmes Prokurorit të Shtetit, përveç që është në diskrecionin e këtij të fundit, do të mund të ngritet nga Prokurori Shtetit vetëm nëse plotësohen kushtet e caktuara ligjore. Gjithashtu, pretendimet e parashtruesit të kërkesës kanë të bëjnë më mënyrën se si Gjykata Themelore dhe ajo e Apelit kanë zbatuar ligjin kur kanë vendosur lidhur me ligjshmërinë e Urdhrit të përmbarimit, dhe statusin ligjor të faturave të kontestuar. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës nuk paraqet pretendime specifike lidhur me Njoftimin e Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, por paraqet para Gjykatës të njëjtat pretendime që i paraqet ndaj Aktvendimit të Gjykatës së Apelit [Ac.nr.4662/2020], pretendime, të cilat Zyra e Kryeprokurorit nuk ka pasur juridiksion t'i adresojë sepse ajo vetëm ka kompetencë të paraqesë kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë para Gjykatës Supreme dhe jo të vlerësojë shkeljet ligjore të bëra nga Gjykata e Apelit. Andaj, lidhur me këto pretendime, në rastin e parashtruesit të kërkesës, pas pranimit të Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, [Ac.nr.4662/2020] të 25 majit 2021, asgjë nuk e ka ndaluar atë t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese.
50. Andaj, Gjykata vlerëson se *“vendim i fundit”*, sipas nenit 49 të Ligjit, lidhur me procedurat që ndërlidhen me faturat e kontestuar për të cilat ishte lëshuar Urdhri përmbarimor, konsiderohet Aktvendimi i Gjykatës së Apelit [Ac.nr.4662/2020] i 25 majit 2021, me të cilin ishte refuzuar ankesa e parashtruesit të kërkesës kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore [PPP.nr.783/2019] të 24 korrikut 2020 (shih, *mutatis mutandis*, rastin e GJEDNJ-së *Paul dhe Audrey Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, aplikimi nr.46477/99, Vendim i 14 marsit 2002; shih rastin e Gjykatës KI115/20, parashtrues *Muharem Rama*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 2 dhjetorit 2021, paragrafi 51).
51. Në lidhje me këtë, Gjykata rikujton se Aktvendimi i Gjykatës së Apelit [Ac.nr.4662/2020] ishte nxjerrë më 25 maj 2021. Në faqen e parë të Aktvendimit të Gjykatës së Apelit i cili gjendet në shkresat e lëndës parashtruesi ka shkruar datën e pranimit të tij, e që rezulton të jetë 21 qershor 2021. Lidhur me këtë, Gjykata vëren se koha në mes të pranimit të Aktvendimit dhe të datës së parashtrimit të kërkesës së tij, më 29 dhjetor 2021, në Gjykatën Kushtetuese, ka kaluar periudhën kohore prej 4 (katër) muajsh.

52. Si pasojë, Gjykata konkludon se kërkesa e parashtruesit të kërkesës në lidhje me Aktvendimin e Gjykatës së Apelit [Ac.nr.4662/2020] të 25 majit 2021, është dorëzuar pas afatit ligjor prej 4 (katër) muajsh.
53. Gjykata rikujton se qëllimi i afatit ligjor prej 4 (katër) muajsh, sipas nenit 49 të Ligjit dhe sipas rregullit 39 (1) (c) të Rregullores së punës, është që të promovojë siguri juridike, duke siguruar që rastet që kanë të bëjnë me çështje kushtetuese të trajtohen brenda një periudhe të arsyeshme dhe vendimet e mëparshme të mos jenë vazhdimisht të hapura për t'u kontestuar (shih, ndër të tjera, rastet e GJEDNJ-se: *Mocanu dhe të tjerët kundër Rumanisë*, kërkesat nr. (10865/09, 45886/07 dhe 32431/08), te 17 shtatorit 2014, paragrafi 258; *Lopes de Sousa Fernandes kundër Portugalisë*, nr. 56080/13, te 19 dhjetorit 2017, paragrafi 129; shih gjithashtu, ndër të tjera, rastet e Gjykatës KI120/17, me parashtrues *Hafiz Rizahu*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 7 dhjetorit 2017, paragrafi 39; KI115/20, cituar më lartë, paragrafi 54).
54. Ky afat gjithashtu i mundëson parashtruesit potencial te kërkesës që te shqyrtoje nëse dëshiron te paraqesë kërkesë dhe, nëse dëshiron, te vendose për ankesat dhe argumentet konkrete që duhet ngritur dhe ne te njëjtën kohe lehtëson vërtetimin e fakteve në këtë rast, meqë me kalimin e kohës, çdo shqyrtim i drejte i çështjeve të ngritura behet problematik (shih Aktgjykimin e GJEDNJ-se Sabri Gunes kundër Turqisë, aplikimi nr. 27396/06, te 29 qershorit 2012, paragrafi 39; shih po ashtu edhe rastin e Gjykatës KI12/20, parashtruese e kërkesës *Hamijete Dinarama-Daija*, Aktvendim për papranueshmëri, i 6 nëntorit 2020, paragrafi 42).
55. Ky rregull specifikon afatin kohor për kontrollin e ushtruar nga Gjykata dhe paralajmëron individët dhe autoritetet shtetërore për afatin pas të cilit kontrolli i 9 i tillë nuk është me i mundur (shih Vendimin e GJEDNJ-se Walker kundër Mbretërisë së Bashkuar, nr. 34979/97, te 25 janarit 2000; shih, gjithashtu, Aktgjykimin e GJEDNJ-se, Sabri Gunes kundër Turqisë, te cituar më lart, paragrafi 40; shih po ashtu edhe rastet e Gjykatës KI53/18, parashtrues i kërkesës Hajri Ramadani, Aktvendimi për papranueshmëri, i 6 dhjetorit 2018, paragrafi 45; KI115/20, cituar më lartë, paragrafi 56).
56. Andaj, mbi bazën e arsyetimeve të mësipërme, Gjykata konkludon se kërkesa e parashtruesit të kërkesës është dorëzuar jashtë afatit ligjor të përcaktuar me nenin 49 të Ligjit dhe me rregullin 39 (1) (c) të Rregullores së punës, dhe si e tillë është e papranueshme.

## PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenet 21.4 dhe 49 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 39 (1) (c) të Rregullores së punës, më 8 qershor 2022, njëzëri

## VENDOS


- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- I. T'UA KUMTOJË këtë Aktvendim palëve;
- II. TË PUBLIKOJË këtë Aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- III. Ky Aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

**Gjyqtarja raportuese**

  
Remzie Istrefi Peci



**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**

  
Gresa Caka Nimani